



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA KOMBËTARE E DUHAN – CIGAREVE

RAPORT MONITORIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT 2025
AGJENCIA KOMBËTARE E DUHAN - CIGAREVE

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	
METODOLOGJIA E MONITORIMIT	
PROGRESI NE ZBATIM DHE GJETJET E RAPORTIT	
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	

1. Hyrje

Ky raport monitorimi synon të vlerësojë nivelin e zbatimit të Planit të Integritetit të Agjencise Kombëtare të Duhan - Cigareve për periudhën 2025-2027.

Plani është hartuar në përputhje me objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit dhe ka për qëllim rritjen e integritetit institucional dhe transparencës në ofrimin e shërbimeve publike.

2. Metodologjia e Monitorimit

Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit është kryer nëpërmjet:

- Vlerësimit të dokumentacionit dhe praktikave institucionale;
- Intervistave me stafin e institucionit;
- Analizës së riskut dhe masave të zbatuara;
- Raportimit të rregullt nga strukturat përgjegjëse për implementimin e masave.

Koordinatori i Integritetit ka kryer vlerësime çdo gjashtë muaj, duke analizuar përparimet dhe sfidat në zbatimin e Planit të Veprimit.

- Grupi i Punës për Hartimin e Planit të Integritetit

Emri	Pozicioni
Elvira Shyti	Kryetar, Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit Cileor të duhanit
Blerta Dersha	Koordinatore/Specialiste e Sektorit të Prodhim – Perpunimit dhe Lic. të duhait
Kaliopi Drushku	Specialiste e Sektorit të Vlerësimit Cileor të duhanit
Nertila Bardhaj	Specialiste e Sektorit të Vlerësimit Cileor të duhanit

3. Progresi në Zbatimin e Planit të Integritetit

- Objektivat Strategjike 2025-2027

Nr.	Objektivi
1	Përmirësimi i sistemit të menaxhimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me MBZHR dhe drejtoritë përkatëse të saj.
2	Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga struktura përkatëse.
3	Sigurimi i paanshmërisë në raportimin e rezultateve
4	Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në AKDC

3.1 Përmirësimi i sistemit të menaxhimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me MBZHR dhe drejtoritë përkatëse të saj.

- Përgjegjësit e sektoreve prezantojnë tek dega e finance nevojat për financime sipas natyrës së sektoreve
 - Në fund të çdo viti AKDC dërgon nevojat për buxhet për vitin paraardhës. Ministria miraton buxhetet sipas prioriteteve lidhur me politikën e saj strategjike. Theksojmë se dergimi i këtyre planeve nga MBZHR në kohë ndihmon në realizimin me cilësi të këtyre planeve
- Procedurat e Prokurimit kanë vonesat përkatëse kjo e lidhur ngushtësisht me procedurat që ndjek KPP në varësi të ankesave të OE. Nuk ka patur vonesa në startim.

Sfida: Rritja e transparencës në publikimin e raporteve financiare për interesin publik.

3.2 Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga struktura përkatëse.

- Ka bashkëpunim ndërmjet palëve sa herë del një akt ligjor dhe nënligjor i ri ku përfshihet AKDC. Në vijim të zbatimit të masës së parashikuar në kohën e paraqitjes së një detyre të përbashkët, akti, kërkesë, etj., kryhen takimet me specialistët e fushës konkrete që preket, diskutohet merret mendimi i ekspertit etj. Në rastet kur kërkohet të bashkëpunohet me institucionet e tjera dhe përpunohet informacioni.

3.3 Sigurimi i paanshmërisë në raportimin e rezultateve

- Në AKDC pranimi i mostrave bëhet sipas Rregullores së brendshme dhe përgjegjes për këtë është Përgjegjësi i sektorit të Vlersimit Cilezor të duhanit dhe Cigareve. Te gjitha mostrat kanë kodin dhe deklaratën e paansisë.
- Kampionet e mostrave vijnë të kodifikuara në laborator sipas ISO 17025
- Realizuar: Deklaratat e paansisë e firmosura nga personeti (specialistët dhe laborantët)
- Realizuar: Aplikimi për testim bëhet nga subjekti apo klienti on-line në e-albania. Certifikatat e cilësive apo Raport analizat i kalojnë subjekteve pas firmosjes nga titullari nëpërmjet e – albanias.

3.4 Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në AKDC

- Realizuar në përqindjen më të madhe të punës, për vet natyrën teknike që AKDC ka dhe emergjencave laboratorike që paraqiten herë pas here. Rastet e vonesave që lidhen me fondet buxhetore të alokuara lidhen me: vonesat në procedurat e prokurimit; politikën e reja të cilat nuk janë shoqëruar me buxhet dhe duan kohën e tyre për të plotësuar kriteret për ofrimin e shërbimeve (metodave të reja); nevojën për burime njerëzore referuar kërkesave të reja.
- Struktura e AKDC funksionon me urdhër të Kryeministrit nr.206, datë 04.12.2023, “Për një ndryshim në Urdhërin nr.34, datë 07.03.2012, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Duhan Cigareve”. Kjo strukturë si dhe strukturat e tjera ndër vite ka ende mangësi të plotësimit të vendeve vakante nga DAP. Aktualisht kemi ende 2 vende vakante të paplotësuara të cilat potencialisht krijojnë vonesa në realizimin e detyrave.
- Realizuar. Në rastet e largimeve nga puna ndiqen rregullat që përcakton ligjin për Nënpunësin Civil, Kodi i Punës dhe Rregullat institucionale.

Kemi marre trajnime nga projekte te ndryshme te ASPA. Por duke qene qe jemi nje institucion ne zhvillim kemi nevojë per trajnime nderkombetare ne fushen e vleresimit te duhanit dhe produkteve te tij.

Sfida: Duhet të rritet digjitalizimi i arkivës për të siguruar akses më të shpejtë dhe siguri më të madhe të informacionit dhe dorëzimi i dokumentave të prodhuara ndër vite.

- Risqet e Integritetit dhe Vlerësimi i Tyre

Nr.	Fusha	Përshkrimi i Situatës	Risku i Integritetit
1	Menaxhimi financiar	Nuk janë konstatuar probleme me dokumentacionin financiar, buxhetin apo prokurimet.	Pa risk
2	Menaxhimi i burimeve njerëzore	Ka 2 vende vakante dhe mungon një jurist dhe një specialist IT.	Risk i mesëm
3	Arkivimi dhe administrimi i dokumenteve	Dokumentacioni është i unifikuar, me protokoll dhe arkivim sipas rregullave.	Pa risk
4	Zbatimi dhe realizimi i projekteve	Nevojitet më shumë mbështetje logjistike për specialistët e institucionit.	Risk i mesëm

- Masat për Menaxhimin e Risqeve të Integritetit

Nr.	Masa e Marrë	Afati	Përgjegjësi
1	Kërkesa MBZHR dhe DAP për shpalljet e vendeve vakant.	2025-2027	Titullari i AKDC-së
2	Kërkesë në PBA 2026-2028 për investimin blerje mjeti për përmirësimin e infrastrukturës për specialistët në terren	2025-2027	Titullari i AKDC
3	Rritja e transparencës në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore	2025	Koordinatori i Integritetit
4	Monitorimi i rregullt i planit të integritetit	Çdo 6 muaj	Koordinatori i Integritetit

Aktiviteti	Frekuenca	Përgjegjësi
Mbledhja e të dhënave për zbatimin e planit	Çdo 6 muaj	Koordinatori i Integritetit
Raportimi i progresit	Vjetor	Titullai i AKDC
Publikimi i rezultateve	Çdo vit	Institucioni dhe MBZHR

4. Përfundime dhe Rekomandime

4.1. Përfundime

Nga monitorimi i deritanishëm rezulton se:

- Institucioni ka bërë përparime të dukshme në zbatimin e planit të integritetit, sidomos në menaxhimin financiar dhe arkivimin e dokumenteve.
- Vështirësitë kryesore lidhen me mungesën e burimeve njerëzore.
- Transparenca dhe monitorimi i brendshëm janë përmirësuar, por ka ende hapësirë për përmirësime në rekrutimin dhe digjitalizimin e shërbimeve.

4.2. Rekomandime

- Përmirësimi i burimeve njerëzore: Plotësimi i vendeve vakante dhe prania e një sektori të ri marketingu.
- Digjitalizimi i dokumentacionit: Kalimi në sisteme dixhitale për arkivimin dhe administrimin e dokumenteve.
- Rritja e transparencës: Publikimi i raporteve periodike mbi aktivitetet dhe shpenzimet institucionale.

5. Përfundim

Zbatimi i Planit të Integritetit në AKDC ka pasur një ecuri pozitive, me përparime të dukshme në disa fusha kyçe. Megjithatë, disa sfida mbeten ende të pazgjidhura dhe kërkojnë përmirësime të mëtejshme për të arritur objektivat e plota të planit deri në fund të vitit 2025

Data: 10/03/2026

Koordinatori i Integritetit: Blerta Dersha